



Më: 18-06-2018
Dana

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:006042
Datë: 30.04.2018
Numri i dokumentit: 00031820

P.nr.325/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-
Divizioni Penal- në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend
Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED]
[REDACTED] pa nr., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 297-
2/2018 të datës 22.02.2018, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-
së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 297-
2/2018 të datës 22.02.2018 për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 30.04.2018 mori:

AKTGJYKIM

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 297-2/2018 të
datës 22.02.2018 , gjykata jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] pa nr ., i lindur më
[REDACTED] në fshatin [REDACTED] Komuna e Ferizajt, nga babai [REDACTED] e e ëma [REDACTED] e gjinisë
[REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bukëpjekës, i gjendjes së mesme
ekonomike, posedon numrin personal [REDACTED], shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse : më datën 11.01.2018 rreth ores 10:02 në Ferizaj ,pasi që e dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizajikishte refuzuar kërkesën e të pandehurit për lidhje dashurie e ka kanosur nëpërmes telefonit [REDAKTUAR] duke i dërguar mesazhe me përmbajtje kërcënuese “se rri në shpi sa nuk është bërë ma e madhe, mos ma qit imazhin e keq mu dhe vetes me than gjithnja u tranu pa vranë gjinë se unë e kam vendos po ki me marr në qafë edhe najkan tjetër”, ku tek e dëmtuara ka shkakuar frikë të madhe ,-

Me të cilën ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

GJYKON

Me DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 euro(me shkronja:Dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rrga [REDAKTUAR] pa nr., për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 297-2/2018 të datës 22.02.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, e njashtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 297-2/2018 të datës 22.02.2018, me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e veprës penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Deklaratat e të pandehurit e dt.18.01.2018 dhe të dëmtuarës e dt.21.01.2018, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së, gjykata i shqiptoi të pandehurit dënimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 463 të KPPRK-së, E dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.


Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.325/18, datë 30.04.2018

Zyr.ligjor
Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,
Elmaz Zenuni



Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimin të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ndërkaq,pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nga një kopje u dërgohet PTH-së dhe të dëmtuarit.